

Papa: nuk mund të jemi besimtarë të vërtetë pa Jezu Krishtin

“I krishteri kurrë nuk duhet të harron se qendra e jetës së tij është Jezu Krishti”: këtë nënvizoi Papa Françesku gjatë homelisë së Meshës së Shenjtë kremtuar sot në shtëpinë Shën Marta në Vatikan. Papa Bergoglio kujtoi se duhet të lirohemi nga hamendësomi se të mund “të jemi të krishterë pa Jezu Krishtin” apo të krishterë që “kërkojnë vetëm devocion apo përsëpirtëri, por pa Jezusin”. Tërë homelinë e Meshës të shtunën Papa ia kushtoi Jezusit si qendër e jetës së një të krishteri. “Jezusi – tha – është qendra. Jezusi është Zotëria”. E megjithatë, konstatoi, kjo fjalë jo gjithmonë kuptohet mirë, “nuk kuptohet shumë lehtë”. Jezusi, pohoi Papa, “nuk është një zot i këthillë apo i atillë”, po “Zoti, i vetmi Zot”. Ai pra është qendra që “na rilindë e mbi Të rrënjosemi”, ky është Zoti: “qendra”. Farisenjtë për të cilët flet Ungjilli i sotëm, vërejtë Papa, e vendosnin “qendrën e religjiozitetit të tyre mbi shumë urdhra”, E edhe sot, “nëse Jezusi nuk është në qendër, do të jenë sendet tjera”. Ja se pse atëherë “takojmë shumë të krishterë pa Krishtin, pa Jezusin”:

“Për shembull, ata të cilët e kanë sëmundjen e farisenjve e janë të krishterë që jetën e tyre, religjiozitetin e tyre e vendosin apo mbështesin në shumë urdhra: në shumë... Ah’, më duhet të bëj këtë, më duhet të bëj këtë, më duhet të bë këtë...’. Të krishterë të sjelljeve...’Po pse e bënë këtë?’ – ‘Jo: duhet bërë!’. ‘Po pse?’ – ‘Ah, nuk e di, po duhet bërë’. E Jezusi, ku është?’ Një urdhër është i vlefshëm vetëm nëse vjen nga Jezusi: unë bëj këtë sepse Zoti dëshiron që unë ta bëjë këtë. Por pasi që unë jam i krishterë pa Krishtin, e bëj këtë e nuk e di se pse duhet ta bëj”.

Ka, shtoi Papa – “të krishterë tjerë pa Krishtin: ata që kërkojnë vetëm devocion – përsëpirtëri”, “por Jezus nuk ka”. “Nëse devocionet tua të sjellin tek Jezusi – tha Papa – atëherë është puna në rregull. Por nëse ti mbetesh aty, diçka nuk shkon siç duhet”. Pastaj ekziston, vijoi, “një tjetër grup i të krishterëve pa Krishtin: ata që kërkojnë gjëra të rralla, pak si të veçanta, që shkojnë pa dëftimeve private”, ndërsa Dëftimi i Hyjit ka përfunduar me Besëlidhjen e Re. Papa kujtoi se në këta të krishterë ekziston dëshira për të shkuar “në spektakël të dëftimit, për të dëgjuar gjëra të reja”. “Por – tërhoqi vërejtjen duke u drejtuar të tillëve – mos harro të marrësh Ungjillin”. Thotë Bergoglio se nëse

nuk arrijnë të “adhurosh Jezusin, diçka të mungon. Një rregull, një shenjë. Rregullorja është: jam i krishterë i mirë, jam në rrugën e besimtarit të mirë e bëj atë që vjen prej Jezusit dhe bëj atë që më sjell tek Jezusi, sepse Ai është qendra, themeli. Shenja është: unë jam i aftë të adhuroj; adhurimi. Kjo uratë e adhurimit para Jezusit. Hyji na bënë të kuptojmë se vetëm Ai është Zot, është i vetmi Zot. E na jep edhe hirin për ta dashur shumë, për ta ndjekur pas, për ecur asaj udhe që Ai na ka mësuar”.

EJA, SHPIRTI SHENJT,
dhe mbushe zemrën time me dhuratat e Tua.
Bëj që dashuria ime të jetë e vërtetë
dhe zemra ime bujare.
Më ndihmo në nevojat e mia,
dhe ma jep diturinë të bëj çfarë është e drejtë.
Më këshillo kur jam në dyshim,
më forco kundër dobësive të mia,
më mbro kur jam i tunduar
dhe më ngushëllo kur jam i frikësuar.
Ki mirësi të më dëgjosh, O Shpirti Shenjt,
dhe mbushe me dritën tënde zemrën, mendjen dhe
shpirtin tim.
Më ndihmo të jetoj një jetë të shenjtë
dhe të rritem i mirë e në hir.
AMEN.

COME, HOLY SPIRIT,
and fill my heart with Your gifts.
Let my love be true
and my charity be generous.
Help me in all my needs,
and grant me knowledge
to do what is right.
Advise me in my doubts,
strengthen me in my weakness,
protect me when I am tempted
and console me when I am afraid.
Graciously hear me, O Holy Spirit,
and pour Your light
into my heart, mind and soul.
Help me to live a holy life
and grow in goodness and grace.
AMEN.

Violeta Selmanaj, Broker
Tony Selmanaj, Sales Representative

Per Shitje, Blerje, Qera Shtëpi, Condo A Po
Biznese Lutemi Na Kontaktoni (Shume Vite
Eksperience Ne Toronto Dhe Rrethinat)

In House Mortgage Broker 25 Years
Experience **Special Rates** Through
Violeta and Tony Selmanaj For Fully
Qualified Applicants.
* Call for Details

Direct (416) 553-5044
Office: (905) 279-8300
Email: vselmanaj@trebnet.com

ROYAL LEPAGE Realty Centre, Brokerage®
2150 Hurontario Street Mississauga, ON L5B 1M8

BEQIRI
PROFESSIONAL CORPORATION

Ylli BEQIRI CPA.CGA

Tel: 416-854-9156
Fax: 1-888-838-7736
974 The Queensway,
Toronto ON M8Z 1P6
ybeqiri@sympatico.ca
www.beqiriaccounting.com

Pregaditja e buletinit u mundësua nga KAFE SHQIPTARE® SKËNDERBEU, Shijo Traditën – Tel: 1-647-874-3435, store.albaniancoffee.org



Misioni Shqiptar 'E Lumja Nënë Tereza'

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 Fax. 416 253 5899
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 11:15 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

LLOGARITE


8 Shtator 2013



Në atë kohë, një mori e madhe e popullit po bënte rrugë me të. Jezusi u kthye kah ata dhe u tha: “Nëse ndokush vjen tek unë e do më tepër babën, nënën, gruan, fëmijët, vëllezërit, motrat, madje edhe jetën e vet se mua, nuk mund të jetë nxënësi im. Kush nuk e mbart kryqin e vet e nuk më vjen pas, nuk mund të jetë nxënësi im! Cili prej jush, nëse mendon të ndërtojë kullën, nuk ulet më parë të llogarisë shpenzimet: a ka sa i duhen për ta kryer? Që, kur t’i shtjerë themelet e të mos mund ta kryejë – të mos fillojë ta vërë në lojë gjithkush ta shohë duke thënë: ‘Ky njeri filloi të ndërtojë e nuk mundi ta kryejë!’ Ose – cili mbret, kur do të niset të luftojë kundër një mbreti tjetër, nuk ulet më parë të pleqëroj a është i zoti me dhjetë mijë ushtarë t’i dalë përballë atij, që i vjen me njëzet mijë? Nëse nuk mundet, dërgon një delegacion derisa ai është ende larg e kërkon kushtet për paqe. Kështu, pra, secili prej jush që nuk i bie mohit tërë pasurisë së vet, nuk mund të jetë nxënësi im.” Lk 14, 25-33

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 11:15 te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: **www.ourladyofmm.com** ose kunsulto harten e ketushme.



Kushdo që dëshiron pas Meshes te ofrojë pije freskuese të kontaktojë Vilson Prekaj (tel. 647.855.9643) ose Zef Deklaj (tel. 416. 618.4820)

Kalendari liturgjik...

- 9 Shtator Shen Pjeter Klaver
- 10 Shtator Shen Nikolla i Tolentinos
- 12 Shtator Emri I Zojes
- 13 Shtator Shen Gjon Gojarti
- 14 Shtator Lartesimi i Kryqit te Shenjte
- 15 Shtator Zoja e dhimbshme

Për Kunorën e Martesës... Vini Re!!!

Archdiocese of Toronto ne lidhje me Kunoren e Martese...
http://www.archtoronto.org/contact_us/FAQ.html#marriagefaq
The Archdiocese of Toronto asks that couples contact their local pastor at least one year before their tentatively planned date of marriage. This is to allow for possible delays due to any additional impediments that might necessitate postponing the marriage date, especially in the case of couples with one or more previous marriages. Also, a special second marriage preparation course by Catholic Family Services of Toronto is mandatory before marriage.

Hakun e Kishes per vitin 2013

kane dhene deri tani, Pjeter & Bep Dreshaj, Nush Kaçaj:

- | | |
|-------------------------|----------------|
| Don Gjovani K. | Kokona |
| Agron | Vata |
| Aleks | Coku |
| Aleksander&Adrian Cukaj | |
| Altin | Miri |
| Anton | Brunga |
| Anton | Vulevic (Vulaj |
| Anton & Violeta | Selmanaj |
| Arben | Toma |
| Arben | Marku |
| Astrit & Ermira | Simeqi |
| Benjamin | Hasko |

- Edi
Florenc
Gjek & Lec
Gjergj
Gjergj & Barbara
Gjovalin & Sandra
Jetnor
Kreshnik
Lek
Linda
Luk
Malot
Marin
Mario
Mark
Martin
Nikolin
Nua
Nush
Paulin
Paulin
Pjerin
Pjeter & Bep
Prek
Prek
Rozina
Rrok
Shtjefen
Silvan
Sokol
Tom
Tome
Tony
Viktor
Viktor
Vitor
Vladimir
Zef
Zef
Zef
Zef

- Linadi
Duro
Gashaj
Gjinaj
Nikolla
Selmani
Smakaj
Malaj
Selmani
Kalavaci
Gjolaj
Hasaj
Muzhani
Martini
Shkreli
Pjetri
Vukelaj
Selmani
Kacaj
Marku
Lukani
Kalaj
Dreshaj
Gjonaj
Spaqi
Kalaj
Gjoni
Gjuravçaj
Nerhati
Gashaj
Merditaj
Ivanaj
Isufaj
Dokaj
Pleti
Mernacaj
Doda
Lulaj
Deklaj
Skrela (Shkreli)
Prela

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollarë dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese** gjate vitit. **Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

E doni atdheun duke dashur njëri-tjetrit: Mesazh i Nënë Terezës, drejtuar popullit shqiptar



kjo – fillon ajo përçarje, bazë e lufrave të mëtejshme. Këshillë e bukur në këto kohë të vështira, kur erërat

e luftës po fryjnë mbi botë, sidomos mbi Lindjen e Mesme. Kur shkoi në Shqipëri për vizitën e Papës Gjon Pali II, më 25 prill 1993, në ditët që pasuan, Nënë Tereza i drejtoi një mesazh popullit shqiptar, publikuar në njërën nga gazetatat. Po jua propozojmë të plotë porosinë e së Lumes, që vlen edhe sot: “Dëshiroj t’ju kujtoj lajmin e mirë që na ka sjellë Jezu Krishti: Zoti na do, Zoti na këshillon që ne ta duam njëri-tjetrin, ashtu siç Ai do çdonjërën prej nesh. Dashuria nis nga shtëpia, nga familja. Kur njerëzit rrojnë në paqe midis tyre, kur janë të lidhur e kanë mirëkuptim, kur ushqejnë dashuri për njëri-tjetrin, edhe Zoti i do më shumë dhe i mbron nga të këqijat. Njerëzit, brenda në familje, prindërit e fëmijët, duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin, të jenë së bashku, ta shprehin gëzimin e dashurisë njerëzore, duke e ndarë atë me të tjerët. Kjo ka shumë rëndësi. Nëse në çdo familje do të ketë dashuri, ajo do të përhapet patjetër, do të dalë jashtë tyre, pavarësisht se mund të ketë pengesa. Kam parë kaq e kaq të rinj këtu në Shqipëri që e duan fort njëri-tjetrin. Ata dinë ta tregojnë dashurinë e tyre. Të duash do të thotë të lutesh me gjithë zemër. Lutja vetë është fryti i një ndjenje të thellë dhe të sinqertë. Dhe fryt i dashurisë është mendimi për të bërë mirë. Dhe fryt i bamirësisë e humanizmit është kurdoherë paqja. Ja përse bota duhet t’i falet dashurisë. Njeriu duhet të lutet për të qenë një qenie që merr e jep dashuri, që të jetë bartës e përcjellës i dashurisë së ëmbël të Zotit tek secili prej nesh, tek secili prej vëllezërve dhe motrave të veta. Kështu mund të përhapen dashuria e mirësia në një shumicë njerëzish. Është një gjë e mrekullueshme të shohësh brezin e ri dhe fëmijët që rriten duke përhapur dashuri dhe gëzim. Kam marrë këto ditë një letër prekëse nga një djalë i vogël nga SHBA. Ai më shkruan: “E dashur Nënë Tereza, unë të dua shumë. Unë po jua dërgoj juve të gjitha kursimet e mia“. Në zarf ai kishte futur bashkë me letrën tërë pasurinë e vet prej fëmije: një çek me vlerë tre dollarë. Unë e ndiej se dashuria për njeriun dhe solidariteti me të varfërit po krijon njerëz shpirtmëdhën, që duan t’u dhurojnë të tjerëve gëzim e paqe; që duan t’i pasurojnë edhe ata në shpirt e në jetesë.

Le të falënderojmë Zotin për fuqinë që u fal shqiptarëve për të dashur e ndihmuar njëri-tjetrin. Shqipëria bëhet duke punuar të gjithë së bashku. Zoti e bekoftë çdonjërën prej jush! Unë do të lutem përherë që shqiptarët të kenë bekimin e Zotit. Dua të lutem për ne, për popullin e varfër të Shqipërisë, për popullin e Kosovës që vuan. Zoti ju bekoftë (Ky ishte mesazhi i Nënë Terezës drejtuar bashkatdhetarëve të saj më 30 prill 1993, botuar në gazetën “Shqip”, me titullin **“E doni atdheun duke dashur njëri-tjetrit: Mesazh i Nënë Terezës, drejtuar popullit shqiptar ”.**)

Papa në tweet të ri kërkon: “lutuni për paqe”

“ Lutuni për paqe”. Kështu kërkon Papa Françesku, në një tweet të ri, duke botuar thirrjen në faqe të Facebookut e të Twitterit @Pontifex kushtuar ditës së sotme për paqen në Siri e në botë.

BIRTH OF MARY

September 8th



mission. The birth of Mary is recounted by the Protevangelium of James (5:2), an apocryphal writing from the end of the 2nd century. Subsequent tradition is based on this account.

The description - although in the manner of an apocryphal document - obviously presents an important historical event: the birth of the Mother of the Lord. But the problem that concerns us here is the significance of this event. In the case of all the Saints, the Church commemorates their birthday on the day of their return to the Lord. However, in the cases of St. John the Baptizer and the Blessed Virgin, it also celebrates the day of their earthly birth. This is a singular fact already emphasized in ancient times, for example, by Paschasius Radbertus (d. about 859).

The reason for this fact is not found primarily in the greatness or the privileges of the persons involved but in the singular mission that was theirs in the History of Salvation. In this light, the birth of the Blessed Virgin is considered to be - like that of John the Baptizer - in direct relationship with the coming of the Savior of the world. Thus, the birth and existence of Mary similar to and even more than those of the Baptizer - take on a significance that transcends her own person. It is explained solely in the context of the History of Salvation, connected with the People of God of the Old Covenant and the New. Mary's birth lies at the confluence of the two Testaments - bringing to an end the stage of expectation and the promises and inaugurating the new times of grace and salvation in Jesus Christ.

Mary, the Daughter of Zion and ideal personification of Israel, is the last and most worthy representative of the People of the Old Covenant but at the same time she is “the hope and the dawn of the whole world.” With her, the elevated Daughter of Zion, after a long expectation of the promises, the times are fulfilled and a new economy is established (LG 55).

The birth of Mary is ordained in particular toward her mission as Mother of the Savior. Her existence is indissolubly connected with that of Christ: it partakes of a unique plan of predestination and grace. God's mysterious plan regarding the incarnation of the Word embraces also the Virgin who is His Mother. In this way, the Birth of Mary is inserted at the very heart of the History of Salvation.